



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E KULTURËS**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE**

Nr. 603 Prot.

Tiranë, më datë 19.04.2023

**VENDIM**  
**Nr. 200, datë 19.04.2023**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 *“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”*, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.04.2023:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e raportit të vëzhgimit arkeologjik për projektin *“Strukturë Turistike "Hel-Pet", me 2,3 dhe 4 Kate, me një kat nëntokë dhe me pishinë në Rrugën Vlorë Orikum”*, Radhimë, Vlorë, me aplikues Atelier 4 dhe zhvillues Hel-Pet;
2. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje rastësore siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së, sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 145 - 147;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Klesta QIRICI**

